Financuar nga
Bashkimi Evropian

SHËNIMI RINOR

Çfarë dëgjuam nga të rinjtë në Rahovec dhe çfarë mund të bëhet

Përgatitur nga / Prepared by: Iniciativa për Zgjidhje Inovative (IZI)

Zbatuar nga / Implemented by: NGO Integra and NGO CASA

Gusht / August 2026

Ky shënim është financuar nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Iniciativës për Zgjidhje Inovative (IZI) dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

This Youth Note was funded by the European Union. Its contents are the sole responsibility of Iniciativa për Zgjidhje Inovative (IZI) and do not necessarily reflect the views of the European Union.

Përmbledhje ekzekutive

Ky Shënim Rinor përmbledh gjetjet nga të rinjtë që morën pjesë në Unbound Rahovec dhe paraqet katër masa praktike për akterët që punojnë me të rinjtë.

1. Ta bëjmë pjesëmarrjen kulturore dhe qytetare të rregullt dhe të qasshme

Të rinjtë kanë nevojë për mundësi të vazhdueshme për të marrë pjesë, ndërtuar dhe krijuar. Qendrat rinore duhet të mbështeten si hapësira të përhershme ku aktivitetet zhvillohen gjatë gjithë vitit.

2. Të krijojmë mundësi reale që zëri i të rinjve të dëgjohet

Të rinjtë duhet të mund të ngrenë shqetësime, të propozojnë zgjidhje dhe të komunikojnë drejtpërdrejt me vendimmarrës. Dëgjimi duhet të përcillet me përgjigje rrugë të qartë për veprim.

3. T'i lidhim të rinjtë përtej rrethit të tyre të menjëhershëm

Vendi ku jeton një i ri nuk duhet të përcaktojë kë mund të takojë ose cilat mundësi mund të ketë. Shkëmbimet dhe lëvizshmëria mund të zgjerojnë horizontet dhe të forcojnë përkatësinë.

4. T'i bëjmë shkollat vende më të sigurta për të folur

Shkollat duhet të ofrojnë mënyra të qarta dhe të besueshme për të ngritur shqetësime, kërkuar mbështetje dhe reaguar ndaj bullizmit, përjashtimit dhe paragjykimit.

Të rinjtë janë të gatshëm të marrin pjesë dhe mundësitë duhet të vazhdojnë përtej një projekti të vetëm.

Konteksti dhe qëllimi

Iniciativa për Zgjidhje Inovative (IZI) punon mbi parimin se dëgjimi i komuniteteve ndihmon në ndërtimin e zgjidhjeve praktike dhe të qëndrueshme. Unbound Rahovec e dëshmon këtë qasje përmes një pilot projekti.

Komunitetet kanë nevoja të ndryshme. Të rinjtë duhet të dëgjohen dhe të marrin pjesë drejtpërdrejt në vendimet që ndikojnë në jetën e tyre të përditshme.

Çdo i ri duhet të ketë mundësi të barabarta për pjesëmarrje, pavarësisht vendbanimit apo rrethanave të tij.

Të rinjtë jashtë qendrave të mëdha urbane të Kosovës mund të kenë më pak mundësi për pjesëmarrje të rregullt në jetën kulturore dhe qytetare. Informacioni nuk mjafton. Të rinjtë kanë nevojë për hapësira konkrete, njerëz me të cilët mund të lidhen, mundësi për të krijuar dhe kanale për të komunikuar me të rriturit dhe institucionet.

Përmes Unbound Rahovec: Teatri për Përfshirje dhe Zë Qytetar, IZI punoi me një grup të rinjsh në Rahovec dhe përdori teatrin për shprehje, diskutim, bashkëpunim dhe reflektim.

Puna me pjesëmarrësit tregoi se vështirësia më e theksuar ishte komunikimi me të rriturit. Të rinjtë ngritën gjithashtu shqetësime për bullizmin, paragjykimin, përjashtimin dhe mungesën e mundësive kulturore e rinore.

Ky Shënim Rinor përmbledh reagimet e pjesëmarrësve dhe vëzhgimet e projektit. Ai paraqet katër rekomandime praktike për institucionet dhe organizatat që punojnë me të rinjtë.

1. Ta bëjmë pjesëmarrjen kulturore dhe qytetare të rregullt dhe të qasshme

Të rinjtë kanë nevojë për më shumë mundësi që të marrin pjesë, të ndërtojnë dhe të krijojnë.

Evidenca nga piloti. Pjesëmarrësit kërkuan më shumë aktivitete si: më shumë trajnime, vizita në shkolla, kampe aktrimi dhe më shumë mundësi që lidhen me artin dhe teatrin. Një pjesëmarrës e përmendi në mënyrë të veçantë Qendrën Rinore SHL si një hapësirë që mund t'i ndihmojë të rinjtë edhe në të ardhmen.

E njëjta pyetje u përsërit gjatë punëtorive.

"A u kry kaq shpejt?"

Pasi morën një hapësirë për pjesëmarrje, të rinjtë pyetën se kur mund ta bënin përsëri.

Çfarë duhet të ndryshojë

Angazhimi kulturor dhe qytetar i të rinjve duhet të jetë pjesë e ofertës së rregullt lokale. Mbështetja duhet të vazhdojë përtej projekteve të veçuara afatshkurtra.

Qendrat rinore ekzistuese duhet të trajtohen si infrastrukturë e përhershme lokale për këtë punë. SHL Rahovec tashmë është një hapësirë që të rinjtë e njohin, e përdorin dhe ku angazhohen si vullnetarë. Hapësira të tilla mund t'i lidhin të rinjtë me artistë, organizata të shoqërisë civile, shkolla, komuna dhe komunitete të tjera.

Veprimet e rekomanduara

- Komuna t'u jap përparësi programeve të rregullta vjetore në qendrat rinore, krahas ngjarjeve të herëpashershme.
- Qendrat rinore të organizojnë vazhdimisht teatër, art, debat, edukim qytetar, media dhe iniciativa komunitare.
- Shkollat t'i lidhin nxënësit me aktivitetet jashtë shkollës dhe të japin udhëzime të qarta për pjesëmarrje.
- Grantet e vogla për iniciativa të udhëhequra nga të rinjtë mund t'u japin atyre mundësinë të propozojnë dhe krijojnë aktivitetet e veta kulturore ose qytetare.
- Organizatat kulturore dhe artistët të ftohen të punojnë drejtpërdrejt me të rinjtë në komunat jashtë Prishtinës.
- Programet duhet t'u japin të rinjve role aktive: të krijojnë, organizojnë, performojnë, diskutojnë, vullnetarizojnë dhe udhëheqin.

Baza e politikave

Kjo qasje përputhet edhe me parimet më të gjera të politikave rinore. Strategjia Shtetërore për Rininë 2024-2032 e vendos angazhimin qytetar, kulturën, rekreacionin, barazinë dhe përfshirjen ndër fushat ku duhet të forcohen mundësitë për të rinjtë. Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës njeh të drejtën e fëmijëve për të marrë pjesë në jetën kulturore dhe artistike dhe kërkon mundësi të barabarta për këtë pjesëmarrje.

2. Të krijojmë kanale reale që zëri i të rinjve të dëgjohet

Unbound Rahovec korrigjoi një supozim fillestar për komunikimin e të rinjve.

Evidenca nga piloti. Në matjen fillestare, vetëm gjysma e të anketuarve me përgjigje të përdorshme zgjodhën nivelin më të lartë kur u pyetën nëse ndjenin se zëri i tyre kishte rëndësi në komunitet.

Vëzhgimet e facilitatorëve dhe diskutimet me pjesëmarrësit treguan se vështirësia kryesore ishte komunikimi me të rriturit.

Inkurajimi i të rinjve që të 'flasin më shumë' nuk mjafton. Të rinjtë mund të flasin dhe përsëri të ndihen të padëgjuar.

Çfarë duhet të ndryshojë

Komunat, shkollat dhe institucionet e tjera që punojnë me të rinjtë duhet të krijojnë mënyra të qarta dhe të rregullta që të rinjtë të ngrenë shqetësime dhe të kontribuojnë me ide.

Të rinjtë duhet gjithashtu të mund të shohin çfarë ndodhi pasi folën.

Konsultimet duhet të përfshijnë një përgjigje të institucionit dhe një shpjegim të qartë për çfarë mund të bëhet. Përmes këtij procesi, të rinjtë mësojnë si funksionon pjesëmarrja publike.

Veprimet e rekomanduara

- Komuna e Rahovecit mund të organizojë konsultime të rregullta me të rinjtë, edhe jashtë ndërtesës së komunës dhe brenda hapësirave që të rinjtë tashmë i përdorin.
- Përfaqësues të të rinjve mund të takohen periodikisht me zyrtarët komunalë përgjegjës për rini, kulturë dhe arsim.
- Çdo konsultim mund të përfundojë me një përgjigje të shkurtër publike: çfarë ngritën të rinjtë, çfarë mund të realizohet, kush është përgjegjës dhe çfarë kërkon punë të mëtejshme.
- Qendrat rinore mund të mbledhin shqetësime dhe propozime të përsëritura dhe të ndihmojnë në përcjelljen e tyre tek institucionet.
- Shkollat mund të krijojnë forume të strukturuara të nxënësve ku çështjet e ngritura marrin përgjigje nga drejtuesit e shkollës.
- Të rinjtë mund të përfshihen në hartimin e programeve që synojnë pikërisht ata, para se aktivitetet dhe buxhetet të jenë përfundimtare.

Baza e politikave

Ky parim ka edhe bazë të qartë në të drejtat e fëmijëve. Neni 12 i Konventës për të Drejtat e Fëmijës u jep fëmijëve të drejtën të shprehin pikëpamjet e tyre për çështjet që i prekin dhe kërkon që këtyre pikëpamjeve t'u jepet pesha e duhur. Korniza e politikave rinore në Kosovë po ashtu e vendos pjesëmarrjen e të rinjve dhe përfshirjen e tyre në vendimmarrje ndër prioritetet kryesore.

3. T'i lidhim të rinjtë përtej rrethit të tyre të menjëhershëm

Të rinjtë në Rahovec treguan gatishmëri të madhe për të takuar, dëgjuar dhe punuar me të tjerët.

Evidenca nga piloti. Në fund të procesit, të anketuarit u pajtuan fuqishëm se projekti i kishte ndihmuar të dëgjonin dhe të kuptonin njerëzit e tjerë.

Pjesëmarrësit shkruan se u hapën ndaj njerëzve që nuk i njihnin, kuptuan më mirë përvojat e të tjerëve dhe mësuan të dëgjonin. Të rinjtë kanë nevojë për më shumë raste për të takuar njerëz jashtë rrethit të tyre të zakonshëm.

Vendi ku jetojnë të rinjtë nuk duhet t'i kufizojë mundësitë e tyre sociale, kulturore apo qytetare.

Çfarë duhet të ndryshojë

Politikat lokale për rininë duhet t'u krijojnë të rinjve mundësi për të ndërtuar marrëdhënie përtej fshatit, lagjes apo komunës së tyre.

Lëvizshmëria lokale mund të nisë me një udhëtim me autobus, një punëtori të përbashkët, një takim veror ose një vizitë në një qendër tjetër rinore. Këto përvoja i njohin të rinjtë me ide dhe mundësi të reja.

Veprimet e rekomanduara

- Të mbështeten shkëmbime mes fshatrave dhe komunave përmes kulturës, angazhimit qytetar, sportit apo punës komunitare.
- Të mbulohen shpenzimet bazë të transportit kur distanca pengon pjesëmarrjen.
- Të organizohen takime sezonale ose verore që bashkojnë të rinjtë nga pjesë të ndryshme të komunës.
- Të zhvillohen ditë shkëmbimi mes qendrave rinore nga komuna të ndryshme.
- Të ftohen të rinj nga komunitete të tjera në Rahovec dhe njëkohësisht të mbështeten të rinjtë e Rahovecit që të udhëtojnë në vende të tjera.
- Aktivitetet kulturore të shoqërohen me diskutime, ushqim të përbashkët ose detyra bashkëpunuese, në mënyrë që të rinjtë të ndërtojnë marrëdhënie përmes pjesëmarrjes aktive.

Baza e politikave

Këshilli i Evropës e përkufizon punën rinore si veprimtari sociale, kulturore, arsimore dhe qytetare që zhvillohet me dhe për të rinjtë dhe e lidh atë drejtpërdrejt me pjesëmarrjen, përfshirjen dhe vendimmarrjen.

4. T'i bëjmë shkollat vende më të sigurta për të folur

Bullizmi, paragjykimi, përqeshja dhe përjashtimi u shfaqën vazhdimisht në përgjigjet e pjesëmarrësve gjatë Unbound Rahovec.

Evidenca nga piloti. Pas punëtorisë së parë, të anketuarit u pajtuan fuqishëm se ndiheshin të sigurt dhe të respektuar.

Të rinjtë folën për bullizmin, paragjykimin, përqeshjen, ofendimin dhe për rëndësinë e komunikimit të hapur, respektit dhe dëgjimit të njëri-tjetrit.

Shkollat janë ndër vendet ku të rinjtë kalojnë pjesën më të madhe të jetës së tyre të përditshme. Për këtë arsye, ato kanë rol qendror në krijimin e kushteve që të rinjtë të flasin.

Çfarë duhet të ndryshojë

Çdo shkollë duhet të ketë mënyra të qarta dhe të besueshme që nxënësit të mund të ngrenë shqetësime rreth bullizmit, përjashtimit, marrëdhënieve me bashkëmoshatarët dhe komunikimit me të rriturit.

Një i ri duhet ta dijë ku mund të drejtohet, si do të trajtohet shqetësimi i tij dhe çfarë ndodh më pas.

Veprimet e rekomanduara

- Shkollat mund të caktojnë një person të qartë kontakti për bullizëm, përjashtim dhe shqetësime të nxënësve.
- Nxënësit duhet të kenë një mënyrë konfidenciale për të raportuar probleme kur të folurit hapur është i vështirë.
- Klasat mund të zhvillojnë diskutime të udhëhequra për komunikimin, respektin, bullizmin dhe përjashtimin gjatë vitit shkollor dhe pas incidenteve konkrete.
- Mësimdhënësit dhe stafi shkollor duhet ta njohin procedurën e reagimit dhe të referimit të rasteve që kërkojnë mbështetje shtesë.
- Këshillat e nxënësve duhet të kenë rol praktik në identifikimin e problemeve në mjedisin shkollor dhe në propozimin e përmirësimeve.
- Qendrat rinore dhe organizatat e shoqërisë civile mund t'i mbështesin shkollat përmes punëtorive të udhëhequra dhe metodave joformale që u japin nxënësve mënyra të ndryshme për t'u shprehur.
- Shkollat duhet të komunikojnë se çfarë veprimi ndërmerret pas një ankese, në mënyrë që nxënësit të ndërtojnë besim në proces.

Baza e politikave

UNESCO rekomandon një qasje gjithëpërfshirëse të sektorit të arsimit për parandalimin dhe trajtimin e dhunës dhe bullizmit në dhe rreth shkollave, me fokus në krijimin e mjediseve të sigurta dhe gjithëpërfshirëse për të nxënë.

Nga një pilot, në një praktikë të vazhdueshme

Unbound Rahovec ishte një pilot i vogël komunitar, i projektuar për të provuar një qasje dhe për të nxjerrë mësime të zbatueshme.

Të rinjtë janë të gatshëm të flasin, të krijojnë, të takojnë të tjerë dhe të trajtojnë tema të vështira kur kanë një hapësirë të sigurt dhe të strukturuar për pjesëmarrje.

Institucionet mund t'i zbatojnë këto mësime pa e përsëritur modelin e plotë të Unbound Rahovec.

Ato duhet të krijojnë hapësira të rregullta për pjesëmarrje, t'i mbajnë të hapura përtej afatit të një projekti, t'i afrojnë mundësitë me komunitetin dhe t'u përgjigjen propozimeve të të rinjve.

"A u kry kaq shpejt?"

Pyetja e përsëritur tregon kërkesën e pjesëmarrësve për mundësi që vazhdojnë përtej një projekti të vetëm.

Evidenca e projektit

Të dhënat sasiore vijnë nga formularët e reagimit të pjesëmarrësve në Unbound Rahovec. Projekti mblodhi edhe përgjigje cilësore dhe vëzhgime të facilitatorëve.

Këto të dhëna përshkruajnë grupin pjesëmarrës.

Këto rezultate përshkruajnë grupin pjesëmarrës dhe duhet të lexohen si dëshmi nga ky pilot në nivel komunitar, jo si rezultate përfaqësuese për të gjithë të rinjtë e Rahovecit.

Referenca të politikave

- Strategjia Shtetërore për Rininë 2024-2032, Republika e Kosovës - fuqizimi i të rinjve, pjesëmarrja, angazhimi qytetar, kultura dhe përfshirja.
- Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës, nenet 12, 13 dhe 31 - e drejta për t'u dëgjuar, për të shprehur ide dhe për të marrë pjesë në jetën kulturore dhe artistike.
- Rekomandimi CM/Rec(2017)4 i Këshillit të Evropës për Punën Rinore - struktura të qëndrueshme të punës rinore, përfshirje dhe pjesëmarrje aktive.
- Udhëzimet e UNESCO-s për mjedise të sigurta të të nxënit - parandalimi dhe trajtimi i dhunës dhe bullizmit përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse në arsim.

Executive summary

This Youth Note summarises findings from the young people who took part in Unbound Rahovec and sets out four practical measures for the municipality, schools, youth centres and organisations that work with young people.

1. Make cultural and civic participation regular and accessible

Young people need sustained opportunities to take part, build and create. Youth centres should be supported as permanent spaces where activities can continue throughout the year.

2. Create real channels for young people to be heard

Young people should be able to raise concerns, propose solutions and communicate directly with adults and institutions. Listening should lead to a response and a clear route for action.

3. Connect young people beyond their immediate circles

Where a young person lives should not determine whom they can meet or what opportunities they can access. Exchanges and mobility can widen horizons and strengthen belonging.

4. Make schools safer places to speak

Schools should provide clear and trusted ways to raise concerns, seek support and respond to bullying, exclusion and judgment.

Young people are ready to participate, and opportunities should continue beyond a single project.

Context and purpose

The Innovative Solutions Initiative (IZI) works on the principle that listening to communities helps build practical, lasting solutions. Unbound Rahovec tested this approach through a small pilot.

Communities have different needs. Young people should be heard and take a direct role in decisions that affect their daily lives.

Every young person should have equal opportunities to participate, regardless of where they live or their circumstances.

Young people outside Kosovo's larger urban centres can have fewer opportunities to participate regularly in cultural and civic life. Information alone is insufficient. Young people need concrete places to participate, people to connect with, opportunities to create and channels for communicating with adults and institutions.

Through Unbound Rahovec: Theatre for Inclusion and Civic Voice, IZI worked with a group of young people in Rahovec and used theatre as a method for expression, discussion, cooperation and reflection.

The work showed that communication with adults was the more prominent difficulty. Young people also raised concerns about bullying, judgment, exclusion and limited cultural and youth opportunities.

This Youth Note summarises participant feedback and project observations. It sets out four practical recommendations for institutions and organisations that work with young people.

1. Make cultural and civic participation regular and accessible

Young people need more opportunities to take part, build and create.

Pilot evidence. Participants themselves recommended more activities, more training, school visits, acting camps and more opportunities involving art and theatre. One participant specifically described the SHL Youth Centre as something that could help their future.

The same question recurred during the workshops.

"Is it done so soon?"

After receiving a space to participate, young people asked when they could do it again.

What should change

Cultural and civic engagement for young people should be part of regular local provision. Support should continue beyond individual short-term projects.

Existing youth centres should be treated as permanent local infrastructure for this work. SHL Rahovec already provides a place young people know, use and volunteer in. Spaces like this can connect young people with artists, civil society organisations, schools, municipalities and other communities.

Recommended actions

- Municipalities can prioritise recurring annual programmes in youth centres alongside occasional events.
- Youth centres can host regular theatre, art, debate, civic education, media and community-action programmes.
- Schools can connect students with activities outside school and provide clear information on how to take part.
- Small youth-led initiatives can give young people the chance to propose and build their own cultural or civic activities.
- Local cultural organisations and artists can be invited to work directly with young people in municipalities outside Prishtina.
- Programmes should give participants active roles: creating, organising, performing, discussing, volunteering and leading.

Policy basis

This approach also fits wider youth-policy principles. Kosovo's State Strategy for Youth 2024-2032 places civic engagement, culture, recreation, equality and inclusion within the areas in which youth opportunities should be strengthened. The UN Convention on the Rights of the Child recognises children's right to participate in cultural and artistic life and calls for equal opportunities to do so.

2. Create real channels for young people to be heard

Unbound Rahovec corrected an initial assumption about communication among young people.

Pilot evidence. At baseline, only half of usable respondents selected the strongest response when asked whether they felt their voice mattered in their community.

Facilitator observations and participant discussions showed that communication with older people was the main difficulty.

Encouraging young people to 'speak more' is insufficient. Young people can speak and still feel unheard.

What should change

Municipalities, schools and other institutions working with youth should establish clear and recurring ways for young people to raise concerns and contribute ideas.

Young people should also be able to see what happened after they spoke.

Consultations should include an institutional response and a clear explanation of what can be done. Through this process, young people learn how public participation works.

Recommended actions

- Rahovec Municipality can hold regular youth consultations, including sessions outside the municipal building and inside spaces young people already use.
- Youth representatives can meet periodically with municipal officials responsible for youth, culture and education.
- Each consultation can end with a short public response: what young people raised, what can be acted on, who is responsible, and what requires further work.
- Youth centres can collect recurring concerns and proposals and help communicate them to institutions.
- Schools can create structured student forums where issues raised by pupils receive a response from school leadership.
- Young people can be invited into the design of programmes intended for them before activities and budgets are finalised.

Policy basis

This principle has a clear rights basis. Article 12 of the Convention on the Rights of the Child gives children the right to express views on matters affecting them and requires those views to receive due weight. The UN Committee has stressed that listening alone is insufficient; children's views need to be seriously considered. Kosovo's youth-policy framework likewise places youth participation and involvement in decision-making among its priorities.

3. Connect young people beyond their immediate circles

Young people in Rahovec showed a strong willingness to meet, listen to and work with others.

Pilot evidence. At endline, respondents strongly agreed that the project had helped them listen to and understand other people.

Participants wrote about becoming more open with people they did not previously know, understanding other people's experiences and learning to listen to one another. Young people need more chances to meet people outside their usual circles.

Where young people live should not limit their social, cultural or civic opportunities.

What should change

Local youth policy should give young people opportunities to build relationships across villages, neighbourhoods and municipalities.

Local mobility can start with a bus ride, a shared workshop, a summer gathering or a visit to another youth centre. These experiences introduce young people to new ideas and opportunities.

Recommended actions

- Support inter-village and inter-municipal youth exchanges involving culture, civic engagement, sport or community work.
- Cover basic transport costs when distance prevents participation.
- Organise seasonal or summer youth gatherings bringing together young people from different parts of the municipality.
- Develop exchange days between youth centres in different municipalities.
- Bring young people from other communities to Rahovec as well as supporting Rahovec youth to travel elsewhere.
- Pair cultural activities with shared discussions, meals or collaborative tasks so young people build relationships through active participation.

Policy basis

The Council of Europe describes youth work as social, cultural, educational and civic activity carried out with and for young people and connects it directly with participation, inclusion and decision-making. It also calls for sustainable structures and stronger support for youth work at local and national level.

4. Make schools safer places to speak

Bullying, judgment, ridicule and exclusion appeared repeatedly in participant responses during Unbound Rahovec.

Pilot evidence. After the first workshop, respondents strongly agreed that they felt safe and respected.

Young people spoke about bullying, judgment, ridicule and insults and the importance of free communication, respect and listening to one another.

Schools are one of the places where young people spend the largest part of their everyday lives. They therefore have a central role in creating the conditions for young people to speak.

What should change

Every school should have clear and trusted ways for students to raise concerns about bullying, exclusion, relationships with peers and communication with adults.

A young person should know who they can approach, how their concern will be handled and what happens next.

Recommended actions

- Schools can identify a clearly communicated staff contact person for bullying, exclusion and student concerns.
- Students should have access to a confidential way of reporting problems when speaking publicly feels difficult.
- Classes can hold guided discussions about communication, respect, bullying and exclusion throughout the school year and after specific incidents.
- Teachers and school staff should know the procedure for responding and referring cases that require additional support.
- Student councils should have a practical role in identifying problems in school climate and proposing improvements.
- Youth centres and civil society organisations can support schools with guided workshops and non-formal methods that give students different ways to express themselves.
- Schools should communicate what action follows a complaint so that students can build trust in the process.

Policy basis

UNESCO recommends a whole-education approach to preventing and responding to violence and bullying in and around schools and stresses the importance of safe, inclusive learning environments.

From a pilot to a habit

Unbound Rahovec was intentionally designed as a small community pilot to test an approach and identify lessons that could inform future practice.

Young people are ready to speak, create, meet others and explore difficult issues when they have a safe, structured space for participation.

Institutions can apply these lessons without reproducing the full Unbound Rahovec model.

They should provide regular spaces for participation, keep them open beyond a single project, bring opportunities closer to young people and respond to their proposals.

"Is it done so soon?"

The repeated question reflects participants' demand for opportunities that continue beyond a single project.

Project evidence

The quantitative figures come from Unbound Rahovec participant feedback forms. The project also collected qualitative responses and facilitator observations. These data describe the participating group and cannot be generalised to all young people in Rahovec.

Policy references

- State Strategy for Youth 2024-2032, Republic of Kosovo - youth empowerment, participation, civic engagement, culture and inclusion.
- UN Convention on the Rights of the Child, Articles 12, 13 and 31 - the rights to be heard, express ideas, and participate in cultural and artistic life.
- Council of Europe Recommendation CM/Rec(2017)4 on Youth Work - sustainable youth-work structures, inclusion and active participation.
- UNESCO guidance on safe learning environments - preventing and responding to violence and bullying through a holistic education-sector approach.

Financimi dhe përgjegjësia / Funding and responsibility

Ky shënim është financuar nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Iniciativës për Zgjidhje Inovative (IZI) dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

This Youth Note was funded by the European Union. Its contents are the sole responsibility of Iniciativa për Zgjidhje Inovative (IZI) and do not necessarily reflect the views of the European Union.